

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Emine Kaçiku, kryetare, Erdogan Haxhibeqiri dhe Shukri Sylejmani, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit B. Sh., nga Prishtina, të cilin e përfaqëson L. B., me autorizim, kundër të paditurës PTK sh.a. në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson H. I., për shkak të kompensimit të diferencës së pagës , përkitazi me revizionin e të paditurës paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.2894/2015 datë 21.4.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 18.10.2016, merr këtë:

### A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr. 2894/2015 datë 21.4.2016, përkitazi me pjesën e kërkesëpadisë që ka të bëjë me anulimin e aktvendimit të paditurës nr.01-1040- 41/2012 datë 7.3.2012, me të cilin paditësit i është zvogëluar lartësia e gradës së punës nga 6 në 5.

Pranohet revizioni i të paditurës në pjesën I të dispozitivit që ka të bëjë me detyrimin e të paditurës që paditësit t'i paguaj ndryshimin e pagës , ndryshimin e bonusit dhe trustit në mesë të gradës 6 dhe 5 , për çdo muaj duke filluar nga data 1.2.2012 e në muajt në vazhdim sipas kontratës së punës me të cilën paditësi të e paditura ka themeluar marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar, me kamatë vonese 4%, duke filluar nga data 1.2.2012 , deri në pagesën e plotë, në afat prej 15 dite , nga dita e marrjes së aktgjykimit , nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë ,dhe në këtë pjesë **prishen** aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr. 2894/2015 datë 21.4.2016, dhe ai i Gjykatës Themelore, Prishtinë C.nr.1204/2012 datë 18.11.2014, ndërsa lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

### A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore, Prishtinë, C.nr.1204/2012 datë 18.11.2014 , është aprovuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësit, është anuluar aktvendimi i të paditurës nr.01-1040- 41/2012 datë 7.3.2012, dhe është detyruar e paditura që paditësit t'i paguaj ndryshimin e pagës , ndryshimin e bonusit dhe trustit në mesë të gradës 6 dhe 5 , për çdo muaj duke filluar nga data 1.2.2012, e në muajt në vazhdim sipas kontratës së punës me të cilën paditësi te e paditura ka themeluar marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar, me kamatë vonese 4%, duke filluar nga data 1.2.2012 , deri në pagesën e plotë, në afat prej 15 dite , nga dita e

marrjes së aktgjykimit , nën kërcënim të përmbarimit me dhunë. Është vendosur që secila palë t'i bart shpenzimet e veta të procedurës.

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr. 2894/2015 datë 21.4.2016, është refuzuar si e pabazuar ankesa e të paditurës, dhe është vërtetuar aktgjykimi i lartpërmendur i gjykatës së shkallës së parë, përveç përkitazi me kamatën e aprovuar , në të cilën pjesë i njëjti aktgjykim është ndryshuar, ashtu që është detyruar e paditura që paditësit në shumat e gjykuara t'i paguajë kamatën të cilën e paguajnë bankat vendore si për deponimet në kursim me afat mbi 1 vit pa destinim të përcaktuar, e cila kamatë duhet të llogaritet posaçërisht për çdo muaj, varësisht nga arritja e të njëjtës, që nga dita e ushtrimit të padisë, më 15.5.2012 , deri në pagesën përfundimtare, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, e paditura me kohë ka paraqitur revizion për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të pranohet revizioni dhe të prishen të dy aktgjykimet e lartcekura , dhe lënda të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 215 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), shqyrtoi aktgjykimin e goditur me revizion , dhe gjeti se:

Revizioni i të paditurës është pjesërisht e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se sipas kontratës së punës të lidhur në mes të paditësit dhe të paditurës si punëdhënës , për kohë të pacaktuar, paditësi ka themeluar marrëdhënie pune në vendin e punës anëtar i ekipit të tel. Shitjes, në lokacionin e Prishtinës, ndërsa të njëjtit i caktohet paga bazë për punën të cilën e kryen në lartësi të gradës 6. Mirëpo me aktvendimin e të paditurës nr.01-1040- 41/2012 datë 7.3.2012, paditësit i caktohen të ardhurat personale në lartësi të gradës 5, duke filluar prej datës 1.2.2012 e tutje, duke e konsideruar këtë aktvendim si pjesë përbërëse të kontratës së punës, me këshillë juridike se ky aktvendim mund të ankimohet në komisionin e ankesave në afat prej 8 ditëve. Paditësi është ankuar kundër këtij aktvendimi, por nuk ka marrë përgjigje prej të paditurës. Zvogëlimi gradës së pagesës për paditësin , prej 6 në 5, sipas të paditurës është bërë në bazë të shkresës së Ministrit B. B., të datës 6.12.2011 drejtuar Kryetarit të Bordit të drejtorëve të paditurës me qëllim të ngritjes së vlerës së përgjithshme të PTK-së, në të cilën shkresë është kërkuar që niveli i përgjithshëm i shpenzimeve operative vjetore duhet të reduktohet për vitin 2012 në jo më shumë se 20%.

Në këtë gjendje faktike të vërtetuar kësisoj gjykata e shkallës së parë gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar , andaj anuloi vendimin kontestues të paditurës për

zvogëlimin e pagës së paditësit prej gradës 6 në 5, dhe detyroi të paditurën që paditësit t'i paguajë diferencën e pagës sipas gradës 6, pasi që gjeti se e paditura me zvogëlimin e gradës së paditësit prej 6 në 5, në mënyrën e përshkruar më lartë, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 11 par.1 pika 1.8 dhe nenit 55 par.2 të Ligjit të Punës, dhe nenit 3 të Kontratës së punës. Gjykata e shkallës së parë vlerëson se marrëdhënia e punës e lidhur në kontratën e përshkruar më lartë në mes të paditësit dhe të paditurës është marrëdhënie kontraktore e krijuar në bazë të kushteve për lidhjen e saj, duke përfshirë aftësitë e palëve kontraktuese, vullnetin e tyre, lëndën dhe bazën e kontratës. Palët sipas parimit të së drejtës, me vullnetin e tyre të lirë kanë krijuar raporte reciproke juridike, të cilat mund t'i ndryshojnë gjithashtu vetëm me vullnetin reciprok të tyre. Prandaj, rezulton se kontrata e punës dhe kushtet e saj nuk mund të ndryshohen në mënyrë të njëanshme nga i padituri duke cenuar të drejtat kontraktuese të paditësit. Aktvendimi i goditur i të paditurës është i kundërligjshëm, dhe si i tillë nuk mund të trajtohet si pjesë e kontratës, përderisa për ndryshimin e kontratës dhe kushteve të saj me këtë aktvendim, nuk ka dhënë pëlqimin edhe pala tjetër kontraktuese këtu paditësi.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurë ankimore ka refuzuar si të pabazuar ankesën e të paditurës, dhe ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, duke pranuar si të bazuara të gjitha konstatimet faktike dhe juridike të saj. Për më tepër gjykata e shkallës së dytë gjen se nuk ka prova se e paditura ka bërë ndërhyrje me aktet normative të saj lidhur me zvogëlimin e gradave dhe se kjo nuk mund të bëhet me një vendim të drejtorit menaxhues, ndërsa në bazë të nenit 194 të LPK-ës, për shkak të zbatimit të gabuar të drejtës materiale ka ndryshuar aktgjykimin e ankimuar lidhur me kamatën, duke vendosur si në dispozitivin e atij aktgjykimi.

Në një gjendje të tillë faktike, Gjykata Supreme e Kosovës pranon si të bazuar qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së dytë dhe asaj të parë, lidhur me aprovimin si të bazuar të kërkesëpadisë së paditësit përkitazi me anulimin e vendimit të paditurës për zvogëlimin e gradës së punës për paditësin, prej 6 në 5, pasi që aktgjykimet e këtyre gjykatave nuk janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, e as me zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Për më tepër gjykata e revizionit vlerëson se aktgjykimet e lartcekura në këtë pjesë nuk përfshihen me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore në të cilat gjykata e revizionit kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Objekt shqyrtimi në gjykatën e revizionit ishin pretendimet e revizionit përkitazi me shkeljet thelbësore të dispozitave procedurale nga neni 182.2 pika (n) LPK. Gjykata e revizionit vlerëson se këto aktgjykime nuk përfshihen me të meta e paqartësi as në dispozitiv e as në arsyetimin e tyre, përkundrazi të njëjtat janë të qarta, nuk përmbajnë të meta e paqartësi, në

arsyetim janë dhënë arsye të mjaftueshme lidhur me faktet juridikisht të vlefshme për gjykim të drejtë të kësaj çështjeje juridike, të cilat janë të pranueshme plotësisht edhe për gjykatën e revizionit, andaj këto pretendime të revizionit u refuzuan si të pa bazuara.

U refuzuan si të pabazuara edhe pretendimet tjera të revizionit për shkelje thelbësore procedurale nga neni 182.1 lidhur me nenin 190 e 191 të LPK, të cilat sipas të paditurës qëndrojnë në atë se gjykata e shkallës së dytë me rastin e vendosjes sipas ankesës së të paditurës nuk ka mbajtur seancë gjyqësore për shqyrtimin e çështjes në të cilën është dashur të thirren edhe palët. Këto pretendime të revizionit janë të pabazuara, për faktin se gjykata e shkallës së dytë nuk ka gjetur se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është mbështetur në gjendjen faktike të konstatuar gabimisht apo në mënyrë jo të plotë, kështu që duke vlerësuar edhe se në procedurë ankimore nuk janë paraqitur fakte dhe prova të reja , edhe gjykata e shkallës së dytë nuk ka pas për obligim të mbajë seancë gjyqësore në prezencën e palëve lidhur me ankesën e të paditurës.

Qëndron fakti se në raste tjera të ngjashme gjykata e shkallës së dytë në kolegje të ndryshme ka vendosur ndryshe , mirëpo secili aktgjykim i gjykatës së shkallës së dytë në mënyrë të veçantë , mund t'i nënshtrohet procedurës sipas revizionit me çka për mes vendimit gjyqësor të gjykatës së revizionit eliminohet vendimmarrja e ndryshme e gjykatës së shkallës së dytë për situata të njëjta .

Objekt shqyrtimi në gjykatën e revizionit ishin edhe pretendimet e revizionit për zbatim të gabuar të së drejtës materiale nga neni 78 dhe 79 të Ligjit të Punës. Sipas të paditurës padia e paditësit në pjesën ku është kërkuar anulimi i vendimit për uljen e gradës është e vonuar. Gjykata Supreme vlerëson se në këtë rast paditësi nuk është vonuar me paraqitje të padisë nga se kontesti kryesisht ka të bëjë me pagesën e diferencës së pagës për shkak të një vendimi arbitrar të kundërligjshëm të paditurës për zvogëlimin e pagës , për të cilën kërkesë në kuptim të nenit 87 të Ligjit të Punës afati i parashkrimit është 3 vite e jo siç pretendohet në revizion se afati për paraqitje të padisë për paditësin duhet të llogaritet në pajtim me nenin 78 dhe 79 të Ligjit të Punës.

Për më tepër Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se i punësuarit ka të drejtë në pagë e cila i caktohet të punësuarit me kontratë të punës në pajtim me Ligjin e Punës, kontratën kolektive dhe aktin e brendshëm të punëdhënësit. Paga e paditësit sipas kontratës së punës ka qenë sipas gradës 6 , prandaj ulja e pagës nën këtë gradë është në kundërshtim me dispozitat e kontratës dhe të Ligjit të Punës. Kërkesa e aksionarit Qeverisë së Republikës së Kosovës- Ministrisë së Zhvillimit Ekonomike, lidhur me shpenzimet e uljeve operative te e paditura në

raport me të hyrat e përgjithshme nuk mund të jetë bazë për uljen e pagës së paditësit, pasi që në rekomandimin e Qeverisë nuk janë precizuar se cilat shpenzime operative , e as që thuhet në atë rekomandim për uljen e pagave , dhe se e paditura është dashur të paraqet një plan të detajuar operativ lidhur me uljen e shpenzimeve duke i precizuar ato , por një provë e tillë nga ana e të paditurës nuk është paraqitur, andaj thëniet e revizionit në këtë drejtim janë të pabazuara. Nuk ka prova se e paditura ka bërë ndërhyrje në aktet normative të saj lidhur me zvogëlimin e gradave , dhe se nuk mund të bëhet kjo me një vendim të njëanshëm të drejtorit menaxhues të paditurës.

Mirëpo, aktgjykimet e lartpërmendura në pjesën gjykuese në të cilën detyrohet e paditura që paditësit t'i paguajë ndryshimin e pagës, bonusit të trustit në mes të gradës 6 dhe 5 , përfshihen me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 pika (n) të LPK, pasi që aktgjykimi i shkallës së parë si i tillë është i paqartë në dispozitiv, dhe në kundërshtim me arsyetimin e dhënë meqë në dispozitiv nuk është përcaktuar lartësia e këtij ndryshimi të pagës dhe të bonusit të trustit në mes të këtyre gradave që duhet paguar e paditura. Një aktgjykim i tillë nuk mund të ekzekutohet në mënyrë të dhunshme. Edhe kërkesëpadia në këtë drejtim ka qenë e parregullt. Për shkak të këtyre shkeljeve thelbësore procedurale, gjendja faktike nuk është vërtetuar plotësisht.

Në rigjykim , për këtë pjesë të kërkesëpadiës duhet të ftohet pala paditëse që të bëjë precizimin e kërkesëpadiës, dhe në lidhje me këtë pastaj gjykata e shkallës së parë do të nxjerr prova për të vërtetuar konkretisht se cila është lartësia e ndryshimit të pagës dhe të bonusit të trustit në mes të këtyre gradave, dhe pas administrimit të provave tjera nga shkresat e lëndës , dhe vlerësimit të drejtë të tyre, për këtë çështje do të vendos në mënyrë meritore.

Për arsyet e paraqitura më lart , dhe në pajtim me nenin 222 lidhur me nenin 224.2 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

Rev.nr.285/2016 datë 18.10.2016

Kryetarja e kolegjit,  
Emine Kaçiku